



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:078240

Datë: 16.12.2023

Numri i dokumentit: 05078121

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.287/22

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtësen Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të pandehurave A. D. dhe A. R. për shkak të veprës penale “ Sulm” nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe vepër penale “ Shpërdorim i pasurisë së huaj” nga neni 318 par.1, të KPRK-së, të akuzuara sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.225/22 të datës 19.04.2022, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 04.12.2023, në prezencë të prokurorit së shtetit Dorjan Juniku, të pandehurat A. D. dhe A. R., me datë 04.12.2023 shpalli, ndërsa me datë 15.12.2023 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurat:

1.A. D. , e bija e R., dhe nënës Xh., e gjinisë M., e lindur me dt....., në Pejë, me vendbanim në Gjakovë, rr. “N. T.”, te butiku “O.”, kati 7-të, nr.3, ka të kryer shkollën e mesme, e papunë, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, dhe

2. A. R., e bija e G., dhe nënës A., e gjinisë B., e lindur me dt....., në Pejë, ku edhe jeton, rr. “S. H.”, nr.71, ka të kryer shkollën e mesme, punon shitëse në butik, e pa martuar, e gjendjes së dobët ekonomike, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. i lëshuar nga MPB Republika e Kosovës, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës.

SHPALLËN FAJTORE

Për shkak se :

E pandehur A. D. ,

I. Me datën 17.01.2022 rreth orës 16:30 në Rr. S. H. nr. 71 në Pejë me dashje e përdor forcën ndaj personit tjetër, të dëmtuarës A. R. në atë mënyrë që: për shkak të mos marrëveshjes mes të pandehurës dhe të dëmtuarës lidhur me kthimin e telefonit të markës Iphonë 12 ngjyrë të bardhë i të pandehurës nga e dëmtuara, dhe pasi që e dëmtuara refuzon të ia kthej telefonin e pandehura shkon në shtëpinë e të dëmtuarës dhe pasi që e dëmtuara e hap derën e pandehura e sulmon të dëmtuarën duke e shtyer me duar dhe duke e kap për krahu, dhe pasi që e dëmtuara ndërmerr veprimet inkriminuese si në dispozitivin II edhe e pandehura e kap për flokë dhe të dyjat rrëzohen për toke brenda shtëpisë, duke mos rezultuar me lëndime trupore.

- Me çka ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së

E pandehura A. R.,

II. Në kohën dhe në vendin e lartcekur, me dashje e përdor forcën ndaj personit tjetër, të dëmtuarës A. D. në atë mënyrë që: pasi që e dëmtuara ndërmerr veprimet inkriminuese si më lartë në dispozitivin 1, e pandehura po ashtu e kap për krahu dhe për flokë të dëmtuarën e që të dyjat rrëzohen për toke brenda shtëpisë, duke mos rezultu me lëndime trupore.

- Me çka ka kryer veprën penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së

Në kuptim të nenit 362 par.1 pika 1.1 të KPPRK-së, ndaj të pandehurës Albina Ramaj:

I. REFUZOHET AKTAKUZA

Për shkak se:

III. Në kohë të pacaktuar në muajin dhjetor 2021 në Pejë me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë për vehte, e përvetëson pasurinë e cila i është besuar asaj nga e dëmtuara duke ia dëmtuar dhe shkatërruar, në atë mënyrë që: pasi që e dëmtuara ia huazon për disa ditë telefonin e saj Iphone 12 ngjyrë të bardhë në mënyrë që e pandehura pastaj të ia kthej, dhe pasi që e dëmtuara shkon tek shtëpia e të pandehurës që të ia kërkoj të ia kthej telefonin në

posedim, e pandehura nuk ia kthen duke i thënë se telefonin nuk ta jepi ta kom thy, dhe kurr nuk kam me ta kthy, duke i shkaktuar të dëmtuarës dëm në shumën prej 1100 Euro.

- me çka kishte për të kryer veprën penale “Shpërdorimi i pasurisë së huaj” nga Neni 318 par. 1 të KPRK-së (e dënueshme me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vit).

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42, 46, 48, 49,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

I. Të pandehurave A. D. dhe A. R., secilës veç e veç u shqiptohet:

DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR ne kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të dënuarat nuk do të kryejnë vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, qe do të llogaritet nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. Obligohen të dënuarat qe secila veç e veç në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

IV. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

ARSYETIM

A. Historiku i çështjes dhe vendimi ne lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 19.04.2022 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.225/2022, kundër të pandehurave A. D. dhe A. R. për shkak të veprës penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 04.12.2023 e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan

prokurori i shtetit Dorjan Juniku, të pandehurat A. D. dhe A. R. në të cilën seancë te pandehurat e pranuan fajësinë për veprën penale Sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Ndërsa në lidhje me veprën penale Shpërdorim i pasurisë së huaj nga neni 318 par.1 të KPRK-së, e cila i vihej në barrë të pandehurës A. R., prokurori i shtetit u tërheq nga aktakuza pasi që e dëmtuara A. D. deklaroi se nuk dëshiron që ta ndjek penalisht të pandehurën e as nuk paraqet kërkesë pasurore juridike, e duke qenë se kjo vepër penale ndiqet sipas propozimit të të dëmtuarit, mbi këtë bazë u tërheq prokurori.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit në lidhje me veprën penale të cilën e pranuan të pandehurat, në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurat, pasi që është e qartë se e kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë nga ana e gjykatës, prokurori i shtetit deklaroi “ Meqenëse të akuzuarat e pranuan fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga Gjykata kërkoj që të akuzuarat ti shpall fajtorë ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoi si rrethanë lehtësuese”.

E pandehura A. D. deklaroi “ Ndiha e penduar dhe ndiha keq që ka ndodhur ky rast, ne kemi qen shoqe ne mes veti dhe e kemi pasur këtë problem, mirëpo nuk kemi pasur probleme te tjera pas këtij rasti, dhe dëshiroj që kjo çështje të mbyllet, unë nuk jam e interesuar të vazhdohet procedura ndaj Albanës në lidhje me telefonin.

E pandehura A. R. deklaroi “Me vjen keq që ka ndodh ky rast, nuk është dashtë me ndodh ky rast sepse kemi qene shoqe ne mes veti”.

B. Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat

38, 39, 40, 42, 46, 48, 49, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Përcaktimi i dënimit me burgim të kushtëzuar prej 6 (gjashtë) muajsh, për të pandehurat u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, që sipas praktikës gjyqësore dhe udhëzuesit të Gjykatës Supreme, pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale të kryer nga të pandehurat A. D. dhe A. R. është dënimi prej 6 muajsh.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurat nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, faktin se të pandehurat tashme janë pajtuar në mes vete dhe keqardhja e shfaqur nga të pandehurat me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të pandehurave të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kur u vendos për kushtëzimin ekzekutimit të dënimit me burgim gjykata u bazua në nenin 46, 48 par.1 dhe 2 dhe 49 par.1 dhe 3 të KPRK-së.

Gjykata vlerësoi se me shqiptimin e dënimit më kusht ndaj të pandehurave do të arrihet të realizohet në tersi qëllimi i dënimit, pasi që ky dënim do të ndikoj në rehabilitimin e të pandehurave, në parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale dhe në mënyrë tëarsyeshme shpreh gjykimin shoqëror për veprimet e kryerësit. Tërheqja e vërejtjes të pandehurave se nëse në periudhën verifikuese prej një viti do të kryejnë veprë tjetër penale ndaj tyre do ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitiv të aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që të parandalojë të pandehurat në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Gjykata e shqiptoj dënimin më kusht në përputhje me nenin 49 par.1 të KPRK-së ku thuhet “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë

dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, e ne këtë rast siç u përshkrua me lartë për veprën penale që janë shpallur fajtor të pandehurat është paraparë mundësia e shqiptimit të dënimit me burgim deri në 1 (një) vit.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurave është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryeset nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, siç parashihet në nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim të dëmit e as nuk e udhëzoi në kontest civil të dëmtuarit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte të parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMLORE PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.287/22, me datë 15.12.2023

Procesmbajtësja:

Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjygues:

Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.